

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Skenderaj – Raporti komunal

Tetor 2009

Skenderaj në shifra

Popullsia	Gjithsej	77,058	
	Shqiptarë	99.5%	
	Serbë	0.4%	
	Të tjerë	0.08%	
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	378	
	Numri i fshatrave	49	
Shkollimi	Pa shkollë/ fillore e papërfunduar	15.72%	
	Fillore/e mesme e papërfunduar	37.55%	
	E mesme	37.95%	
	Shkollë e lartë	7.59%	
	Universitet	1.20%	
	Nr. i nxënësve	14,756	
	Nr. i mësimdhënësve	747	
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	3	
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	42	
	Nr. i çerdheve	1	
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
		Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	19
Nr. i mjekëve		24	
Papunësia	Gjithsej	67.39%	
	Meshkuj	63.11%	
	Femra	77.78%	
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	47,005	
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,298	
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	6,185,016	
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	425,000	
	Të hyrat tjera (Euro)	5,760,016	
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	5,472,754 (95%)	
	Shpenzimet kapitale (Euro)	994,425 (82%)	
	Shpenzimet tjera (Euro)	4,478,329 (98.8%)	
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	86.22%	
	LDD	7.96%	
	AKR	3.06%	
	Tjera	2.76%	
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Ramadan Gashi (PDK) 2002-2007: Ramadan Gashi (PDK) 2007-2009: Sami Lushtaku (PDK)		

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Skenderajin

Komuna e Skenderajt është pjesë përbërëse e rajonit të Drenicës dhe shtrihet në qendër të territorit të Kosovës. Skenderaj njihet si vend i rezistencës kombëtare ndaj pushtuesve në çdo periudhë kohore. Rezistenca e fundit kombëtare ndaj pushtetit serb filloi në këtë rajon. Tani Prekazi është vendi që simbolizon rezistencën heroike dhe luftën për liri. Që nga pas lufta, vendi më i vizituar nga qytetarët e anëve tjera të Kosovës dhe nga vendet e tjera është Prekazi. Si pasojë e luftërave të ashpra dhe izolimit që ka pësuar kjo komunë, ajo mbetet më e pazhvilluara në Kosovë sa i përket infrastrukturës. Përveç qytetit të Skenderajt, kjo komunë përbëhet edhe prej 49 lokaliteteve rurale. Ka një territor prej 378 km² dhe ka një popullsi prej mbi 77,000 banorë. Sa i përket numrit të popullsisë Skenderaj radhitet e dhjeta në Kosovë.

Problemet aktuale

Komuna e Skenderajt ende mbetet komuna më e pazhvilluar në Kosovë, edhe pse në dy vitet e fundit ka pasur investime të shumta në infrastrukturë. Komuna e Skenderajt mban vendin e parë në Kosovë sa i përket numrit të të papunëve me 67.39% të të papunë. 1,875 familje me 9,736 anëtarë jetojnë me ndihma sociale (12.63% e popullsisë së përgjithshme). Përveç këtij problemi, qytetarët e komunës së Skenderajt në masë të madhe përballesh edhe më këto probleme:

- Papastërtia e qytetit
- Mosfunktionalizimi i shtëpisë së kulturës
- Kanalizimi
- Mungesa e ujit të pijes
- Braktisja e shkollës nga nxënësit

Një nga shqetësimet e banorëve të Skenderajt është **papastërtia** e qytetit. Edhe pse komuna ka kontraktuar ndërmarrjen 'Komunalia' për pastrimin e qytetit, shpesh mund të vësh nëpër qytet grumbuj mbeturinash pranë kontejnerëve. Në përgjithësi qyteti mirëmbahet nga kjo kompani, por ajo që i pengon qytetarët është se kontejnerët nuk pastrohen pak më shpesh, por ata lejohen që të stërmbushen me mbeturina. Nga kjo vërehet se mungon një intensitet më i lartë i punës së kësaj kompanie. Kjo sa i përket qytetit, kurse në fshatra nuk ka fare organizim të mbledhjes së mbeturinave. Atje qytetarët detyrohen t'i gjuajnë mbeturinat nëpër përrenj, apo vende tjera, prej nga më pas vjen erë e rëndë. Me përjashtim të Prekazit, në asnjë fshat tjetër nuk ka organizim të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave nga shtëpitë.

Mosfunktionalizimi i shtëpisë së kulturës. Shtëpia e kulturës së Skenderajt është ndër objektet e rralla që nuk ishin djegur gjatë luftës. Në këtë ndërtesë, që ka një kapacitet prej 500 ulëseve, para lufte ishin shënuar mjaft aktivitete kulturore. Aty kishin qenë të vendosura edhe zyret e Qendrës Rinore ku ishin mbajtur kurse të ndryshme menjëherë pas luftës. Në objektin e kësaj ndërtese ka qenë edhe një diskotekë e cila është dalluar në Kosovë për nga akustika e saj. Edhe kjo ishte lënë pas dore dhe më pas i është dhënë dikujt me qira. Kandidatët për kryetar komune në fushatën para zgjedhore kishin premtuar se do ta riparojnë shtëpinë e kulturës, premtim që deri më sot nuk është realizuar. Asnjë aktivitet tani më nuk zhvillohet në këtë objekt.

Në qytetin e Skenderajt **kanalizimi** paraqet një problem serioz. Ujërat e zeza mund të vërehen në shumë lagje. Përball një kompleksi banesor, pranë objekteve për banim social, më saktësisht tek 'Ndërtesa e Bardhë', mund të vëresh ujërat e zeza të grumbulluara. Bashkëbiseduesit shprehën se kur bie shi niveli i ujërave të zeza u shkon banorëve deri në afërsi të shtëpive. Kryesisht në pjesën skaj lumit Klina, aty ku derdhen ujërat e zeza kundërmon erë e rëndë. Kjo është tejet shqetësuese për banorët që jetojnë pranë lumit. Sa për ilustrim po përmendim shqetësimin e banorëve të lagjes 'Fidanisht', të cilët vazhdimisht ballafaqohen me kundrimin e ujërave të zeza. Në fshatin Kopiliq i Epërm, ujërat e zeza përzihen me ato të pijes. Pasi që pozita gjeografike e këtij fshati është e tillë që në kodra janë të vendosura shtëpitë, kurse në luginën poshtë tyre gjenden bunarët për ujë të pijes, pas çdo reshje uji i kanalizimeve përzihet me ujin e bunareve. Instituti i Shëndetit Publik ka rekomanduar që ky ujë të mos përdoret për pije, por banorët nuk kanë zgjidhje tjetër. Kur jemi tek ujërat e zeza duhet cekur se Skenderaj ka një fabrikë për përpunimin e ujërave të zeza. Kjo fabrikë ka qenë një donacion që ka kushtuar 5 milion euro, por që ende nuk funksionon. Skenderaj është e vetmja komunë në Kosovë e cila ka impiantin për pastrimin e ujërave të zeza, mirëpo që nuk është vënë në funksion për shkak të pengesave që i kanë hedhur banorët e fshatit Llaushë, ku është vendosur ky impiant.

Pavarësisht prej investimeve në ujësjellës, komuna e Skenderajt ende ka **mungesë të ujit të pijes**. Së pari uji i pijes nuk shkon gjithandej nëpër qytet. Për shembull lagjja Saraj, që njihet edhe si lagja III nuk ka ujë. Po ashtu lagja e dëshmorëve nuk ka ujë. Mungesa e ujit është edhe më e ndjeshme nëpër fshatra. Fshatrat në vazhdim kanë probleme me ujë të pijshëm: Fshati i Turishevcit (Vojniku), Çubreli, Rozala, Abria e Poshtme. Në të gjitha këto fshatra qytetarët ballafaqohen me mungesë të ujit. Shkollat fillore në disa fshatra gjithashtu nuk kanë fare ujë të pijes sikurse shkolla në fshatin Prekaz, Turiqevcë, Tic, Çirez.

Braktisja e shkollës. Një problem shqetësues konsiderohet edhe braktisja e shkollës nga nxënësit. Kjo dukuri është më e theksuar tek femrat se sa tek meshkujt. Vetëm gjatë vitit 2009 gjithsej 22 vajza kanë braktisur shkollën në këtë komunë. Një gjë e tillë kishte ndodhur edhe vitin e kaluar kur 18 vajza kishin braktisur shkollën. Arsyet për largim të shkollës kanë të bëjnë kryesisht me një rënie të interesimit për shkollë tek femrat, kurse tek meshkujt ata largohen kryesisht për shkak të kushteve ekonomike. Gjashtë fëmijë që më parë kishin braktisur shkollën tash punojnë në rrugë.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme, me komunën e Skenderajt ka udhëhequr PDK, përmes dy kryetarëve të ndryshëm. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) kryetar komune ishte Ramadan Gashi (PDK). Në mandatin e dytë (2002-2007), me komunën udhëhoqi po i njëjti person, Ramadan Gashi, kurse në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, PDK konkurroi për postin e kryetarit të komunës me Sami Lushtakun. Lushtaku fitoren e siguroi qysh në raundin e parë të zgjedhjeve duke fituar 20,003 vota apo 86.2 %. Kësisoj, Sami Lushtakut iu besua qeverisja e komunës për dy vitet e ardhshme.

Me disa përjashtime, shumica e premtimeve të dhëna gjatë fushatës parazgjedhore nga kryetari aktual i Skenderajt janë realizuar. Premtimi më madhor që është dhënë nga ana e kryetarit të kësaj komune ka qenë angazhimi në ngritjen e cilësisë në

administratë, arsim dhe shëndetësi. Angazhimi është vërejtur sidomos në aspektin e arsimit, ku mes tjerash është vënë edhe gur themeli i një shkolle profesionale në Skenderaj dhe janë ndërtuar shumë objekte shkollore. Por përveç ndërtimeve në infrastrukturë nuk ka përmirësim në kualitetin e mësimdhënies në përgjithësi. Në administratë ende ka ngecje sidomos për marrjen e dokumenteve ku duhet pritur në radhë të gjata. Premtimet në përgjithësi janë mbushur edhe në aspektin e shtruarjes së rrugëve, sikurse asfaltimi i rrugës Broj-Vojnik-Izbicë apo asfaltimi i rrugës tjetër Gobile – Qirez. Një premtim tjetër që kishte dhënë kryetari Lushtaku ishte zgjidhja e problemit të banimit për familjet e dëshmorëve apo invalidëve të luftës. Për këtë është vënë gur themeli i një kompleksi banesor që do t’u ndahet këtyre familjeve. Por, ende nuk dihet nëse ky kompleks banesor do të kryhet sipas planit, kur dihet se komuna ka tenderuar një kompani e cila i ka borxh komunës 400,000 euro, e që si shkëmbim kjo kompani duhet të ndërtojë këtë kompleks banesor. Por jo të gjitha premtimet janë përmbushur. Deri më tani asgjë nuk është bërë për riparimin e shtëpisë së kulturës. Me gjithë premtimin se shtëpia e kulturës do të marrë një pamje tjetër, ajo vazhdon të mbetet e varfër si për nga investimet ashtu edhe për nga aktivitetet kulturore.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Angazhim në ngritjen e cilësisë në administratë, arsim dhe shëndetësi, ku do të kursej në kategorinë e shërbimeve dhe mallrave	Projekt i realizuar pjesërisht. Në arsim është investuar në objekte shkollore, por në administratë ende ka radhë të gjata për marrjen e dokumenteve, kurse në shëndetësi mungojnë stafi mjekësorë.
Asfaltimi i rrugës Broj-Vojnik-Izbicë, në vlerë prej 700,000 euro;	Projekti është realizuar. Rruga është asfaltuar por vetëm me një shtresë.
Asfaltimi i rrugës Gobile – Qirez në gjatësi prej 5 km dhe që do të kushtoj 400 mijë euro	Projekt i realizuar.
Legalizimi i objekteve që nuk prishin planin urbanistik dhe nga taksa për legalizim do të mbush buxhetin e komunës për dy vjet për 1 milion euro	Projekt i realizuar pjesërisht. Në përgjithësi janë rrënuar disa objekte që kanë prish planin urbanistik.
Riparimi i Shtëpisë së Kulturës	Gjatë këtyre viteve të pasluftës, nuk është bërë asgjë për shtëpinë e kulturës.
Për gjashtë muaj do të zbatohet vendimi i Kuvendit Komunal të qeverisjes paraprake për ndarjen e trojeve “te Pishat” për familjarët e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të UÇK	Projekti tani ka filluar që të realizohet, pasi që është vënë gurthemeli i një banese për banim social, ku pritet që të vendosen familjet e dëshmorëve.

Zgjedhjet lokale në Skenderaj

Komuna e Skenderajt që nga zgjedhjet e vitit 2000 është qeverisur nga PDK. Në zgjedhjet e para të vitit 2000, partitë më të mëdha në këtë komunë dolën të jenë PDK dhe LDK. PDK në ato zgjedhje kishte marrë 18,108 vota apo 27 ulëse në KK, kurse LDK kishte marrë 2,895 vota apo 4 ulëse në KK, ndërsa partitë tjera nuk kishin fituar

as 1 % të votave. Kryetar i Komunës ishte zgjedhur Ramadan Gashi. Ramadan Gashi kishte arritur t'i fitoj zgjedhjet edhe dy vite më vonë më 2002, kur partia e tij PDK bindshëm kishte triumfuar ndaj rivalit më të madh, LDK-së. Kësaj radhe PDK kishte fituar 81.6% të votave karshi LDK-së e cila fitoi 12.3% të votave. Nga 31 ulëse të KK, PDK-së i kishin takuar 26, LDK-së 4 kurse 1 ulëse ishte fituar nga PReK. Ashtu edhe siç pritej, edhe zgjedhjet e vitit 2007 nuk sollën ndonjë ndryshim. Partia më e madhe në këtë komunë PDK, përsëri kishte dominuar në përqindjen e votave, duke fituar 86.2 % të votave apo 27 ulëse në KK, ndërsa ajo e LDK-së për herë të parë nuk kishte fituar as edhe një ulëse. Nga katër ulëset e mbetura, tri ulëse ishin rezervuar për deputetët e LDD-së kurse një për atë të AKR-së.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Skenderajt.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	18108	27	15601	26	20003	27
LDK	2895	4	2352	4	-	-
PReK	-	-	529	1	-	-
LDD	-	-	-	-	1847	3
AKR	-	-	-	-	709	1

Numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte rreth 81.2%, dy vjet më vonë ajo ra në 52.6%, kurse për vitin 2007 mungojnë të dhënat, megjithatë besojmë se ky trend ka vazhduar të bie edhe më tej. Këtë e bazojmë në faktin se për pesë vite numri i votuesve me të drejtë vote është rritur dukshëm, kurse numri i votuesve është pak më shumë se në zgjedhjet e para lokale. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 Nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 47,607 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Skenderaj në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	27707	36923	?	47607
Pjesëmarrja në votime	22498	19433	23200	-
Përqindja e daljes në votime	81.2%	52.6%	?%	-

Buxheti i Komunës

Buxheti i komunës së Skenderajt ka shënuar rritje konstante prej vitit në vit. Po të krahasohet buxheti i vitit 2009 me atë të vitit 2003 mund të vërejmë se buxheti komunal është dyfishuar. Sikurse edhe në çdo komunë tjetër, buxheti i vitit 2009 është dukshëm më i madh se sa buxhetet e viteve të kaluar. Gjatë viteve 2004-2008

buxheti i komunës sillej rreth 4 milion euro, kurse në vitin 2009 buxheti i Komunës së Skenderajt është rritur në 6,185,016 euro që është për 1,286,022 euro më i lartë se ai i vitit 2008.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€3,838,652	€579,890	€134,400	€100,000	€1,532,074	-	€6,185,016
2008	€3,199,997	€663,370	€165,000	€100,000	€770,627	-	€4,898,994
2007	€3,112,853	€600,147	€136,510	€95,000	€727,658	-	€4,672,168
2006	€3,090,362	€538,115	€127,445	€50,000	€700,478	-	€4,506,400
2005	€3,088,615	€515,527	€82,524	€83,500	€484,403	-	€4,254,569
2004	€2,841,392	€1,072,364	-	-	€407,474	€177,595	€4,498,825
2003	€2,375,754	€937,644	-	-	€589,946	€65,799	€3,969,143

Nga tabela e më sipërme mund të vërejmë se kryesisht ka pas një rritje konstante në shpenzimet për rroga dhe mëditjet, gjegjësisht pjesa më e madhe e buxhetit 2009 është ndarë për rroga dhe mëditje që është 3,393,652 euro nga 6,185,015 euro të buxhetit total. Krahasuar me vitin 2008, më 2009 për rroga dhe mëditje janë destinuar afër 638,655 euro më shumë.

Komuna e Skenderajt buxhetin e përgjithshëm të vitit 2008 ka arrit që ta shpenzoj në masën 82% deri në fund të vitit. Kurse sa i përket të hyrave vetanake, komuna ka arrit që të arkëtoj të hyra mbi atë sa ishte planifikuar. Arkëtimi i të hyrave përkundrejt parashikimeve është arrit në masën 121.6%.

Investimet kapitale

Nga buxheti i përgjithshëm, Komuna e Skenderajt për vitin 2009 ka ndarë 1,532,074 euro për investime kapitale, që njëherit është edhe shuma më e madhe e ndarë ndonjëherë për investime kapitale. Për dy vite (2008 dhe 2009), qeveria lokale ka ndarë rreth mbi 2 milion euro për investime kapitale. Në tabelën e më poshtme mund të shihni disa nga projektet e financuara nga ky buxhet.

Tab.5.: Investimet kapitale në Skenderaj gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Ndërtimi i ujësjellësit Polac-Prekaz-Kryshec-Dashec	€62,489
2008	Asfaltimi dhe ndërtimi i trotuarit të rrugës "Tahir Meha"	€84,000
2008	Asfaltimi i rrugës "Mbretëresha Teutë"	€130,904
2008	Ndërtimi i rrugës në lagjen Nr. 2	€55,116
2009	Asfaltimi i rrugës "Rasim Kiqina"	€132,000
2009	Asfaltimi i rrugës "Nëna Terezë"	€127,600
2009	Asfaltimi i rrugës "Xhon Buzuku"	€83,600
2009	Asfaltimi i rrugës "Abedin Rexha"	€66,000

Buxheti për investime kapitale në 2008 ishte shpenzuar në masën 82%. Pjesa më e madhe e këtij buxheti është shpenzuar në tre mujorin e fundit. Deri në fund të

shtatorit 2008 Komuna e Skenderajt kishte shpenzuar vetëm 31.9%. Në gjashtë mujorin e parë të 2009, mjetet për investime kapitale janë shpenzuar në masën 34.9%. Përveç që janë bërë investime kapitale me mjete vetanake, në Komunën e Skenderajt ka investuar edhe niveli qendror me shumë projekte të ndryshme.

Kuvendi Komunal i Skenderajt ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Skenderajt do të ketë në dispozicion 5,912,052 euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Skenderajt 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	6,592,425	7,050,346	7,311,600
Të hyrat vetanake në €	162,396	447,849	476,000
Investimet kapitale në €	1,618,937	2,018,791	2,274,324

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Skenderajt për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 7 milion euro për investime kapitale.

Administrata komunale

Në komunën e Skenderajt të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 1,298. Për dallim nga viti i kaluar, komuna e Skenderajt ka zvogëluar numrin e shërbyesve civil për 5 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Skenderajt duhet të ketë 145 punëtorë administrativ. Momentalisht, kjo komunë ka të punësuar 190 punonjës në administratën komunale, që do të thotë se sipas këtij raporti komuna duhet të largojë 45 pjesëtarë të stafit të saj.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Skenderajt sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1298
2008	1303 ▲
2007	1289 ▲
2006	1266
2005	1302
2004	1367 ▲
2003	1277 ■

Komuna e Skenderajt dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që

duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK i Skenderajt gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK e Skenderajt ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 10 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Komuna e Skenderajt gjatë vitit 2008 ka mbajtur tri debate publike me qytetarë, kurse për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk është mbajtur asnjë tubim. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare komuna e Skenderajt ka pasur 11 kërkesa gjatë vitit 2008. Komuna nuk ka pranuar asnjë petition brenda dy viteve të fundit.

Komuna e Skenderajt ka edhe uebfaqen e saj. Në përgjithësi, ueb faqja si pikë të fortë ka pamjen vizuale porse ka mungesa të konsiderueshme në mbajtje të të dhënave të vazhdueshme edhe për lajmet dhe aktivitetet e fundit që ndodhin në komunën e Skenderajt. Në veçanti, ueb faqja e KK Skenderaj, siç shihet në tabelën e mëposhtme, ka zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me shërbimet komunale.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt (www.komuna-skenderaj.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	3
Organizimi komunal	3
Shërbimet komunale	2.6
Info rreth qytetit	3.38
Projektet komunale	3.5
Lajme& lajmërim	2
Harta e faqes	1
Kontakt	4
Gjuhët	4
Fusha për kërkim	4
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	3.04
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	14

Gjendja në arsim

Arsimi në komunën e Skenderajt është i organizuar në tri nivele, atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Mësimi mbahet kryesisht në gjuhën shqipe, por ekzistojnë edhe

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

dy paralele në gjuhën serbe. Qyteti i Skenderajt ka edhe çerdhen e fëmijëve. Kjo komunë ka gjithsej 42 shkolla fillore bashkë me paralelet e ndara, dhe 3 shkolla të mesme. Numri i nxënësve në shkollat fillore është 11,615, kurse në shkollat e mesme mësimin e vijnë 2,847 nxënës. Në këtë komunë mësimi mbahet edhe në gjuhën serbe dhe atë në dy paralele, në fshatin Syriganë dhe Bajë. Numri i mësimdhënësve në këtë komunë është 747, apo sipas statistikave 1.0 punonjës për 100 banorë, që krahasuar me komunat tjera nuk është numër i mjaftueshëm.

Gjatë dy viteve të fundit në këtë komunë janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore. Në Skenderaj janë ndërtuar më shumë objekte shkollore këto dy vite se në çdo komunë tjetër. Me mjete të MASHT është bërë ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Burojë (71,118 €). Gjithashtu me mjete të MASHT janë ndërtuar edhe këto objekte shkollore: objekti i shkollës fillore në Prekaz (500,000 € janë ndarë më 2008 dhe 750,000 € në 2009); rekonstruimi i shkollës fillore në Turiçevc (260,412 €); objekti i shkollës fillore “Shotë Galica” (120,000 €); objekti i shkollës fillore “Kuvendi i Drenicës” (85,000 €); shkolla fillore në Leqinë (120,000 €); ndërtimi i shkollës “Anton Çetta” (600,000 €). Kurse në fillim të tetorit 2009 është vënë gurthemeli i shkollës profesionale, donacion i Qeverisë Norvegjeze e që kap shumën mbi 4 milion €.

Një nga problemet më të mëdha në arsimin komunal të Skenderajt mbetet braktisja e mësimin nga nxënësit, sidomos nga ato të gjinisë femërore. Menaxhmenti komunal nevojitet që të punoj edhe në këtë drejtim për zgjidhjen e këtij problemi.

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Skenderajt ka një QKMF dhe 5 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 14 amblanca të shpërndara nëpër lokalitet të ndryshme. Numri i mjekëve në këtë komunë është 24, kurse në përgjithësi kjo komunë ka 175 punëtor shëndetësor që është 2.3 punëtor shëndetësor për 1,000 banorë. Megjithatë, në QKMF jo të gjitha repartet shëndetësore kanë personelin e duhur. Aty ende mungon një stomatolog, për të cilin komunarët arsyetohen se nuk ka buxhet të mjaftuar.

Shoqëria civile

Menjëherë pas luftës, në komunën e Skenderajt ishin themeluar organizata të shumta joqeveritare. Ndër ato më aktive ishin ‘Syri i rinisë’ dhe ‘Këshilli Rinor’. Sot këto janë shuar, sikurse edhe shumë të tjera. Nga organizatat e shoqërisë civile që janë aktive janë vetëm shoqatat e dala nga lufta, si: Shoqata e Invalidëve të Luftës, Shoqata për përkujdesje ndaj Familjeve të Dëshmorëve, Shoqata e veteranëve të luftës etj. Në përgjithësi, shoqëria civile nuk është shumë aktive me aktivitete në këtë komunë. Mund të thuhet se nuk ekziston ndonjë monitorim i punës së komunës nga ana e shoqërisë civile.

Mediat lokale

E vetmja radio lokale në këtë komunë është ‘Radio Drenica’. Kjo radio transmeton mbledhjet e Kuvendit Komunal. Raportimet e kësaj radioje janë më shumë raportime protokollare, se sa informim objektiv i qytetarëve për punën e pushtetit komunal.

Pothuajse të gjitha gazetaret ditore kanë edhe korrespondentët e tyre në këtë komunë, shkrimet e të cilëve mund të hasen shumë shpesh në faqet e të përditshmeve kosovare. Në përgjithësi gazetarët konsiderojnë se nuk ekziston një ambient i përshtatshëm për të bërë tema kritike në këtë komunë, si për shembull korrupsioni, nepotizmi, apo mos puna e organeve komunale.

Rendi dhe ligji në Komunën e Skenderajt

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Skenderajt kanë ndodhur 1849 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 67 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Skenderaj (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	126
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	122
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	14
Vjedhje e pyjeve	10
Incidente lidhur me pronën	52
Vjedhje	228
Abuzime seksuale	5
Shkaktim të dëmtimeve trupore	62
Kërcënime	27
Mashtrome	6
Vrasje	10
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifën tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifën e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje, edhe Kuvendi Komunal i Skenderajt ka miratuar rregulloren për tatim në pronë në bazë të së cilës caktohen tri zona brenda komunës dhe normat tatimore sillen nga 0.10% deri 0.19%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Skenderajt

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.12%	0.12%	0.19%	0.17%	0.10%
I	350	320	600	200	100
II	300	280	450	200	100
III	250	200	250	200	100

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Skenderajt zhvillojnë veprimtarinë e tyre afro 1,000 biznese private të llojeve të ndryshme. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Skenderajt. Duke u bazuar në Rregullore komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës (€)
Bankat	1,500
Kompanitë e sigurimit	1,500
PTT	2,000
Hotelet	800
Motelet	300
Supermarketet-Hipermarketet	250 - 350
Vetëshërbimet - Minimarketet	200
Restorantet	300
Kafeteritë	200
Gurthyesit	1,000
Prodhimi i asfaltit	1,200
Minierat e thëngjillit	3,000
Industria e materialt ndërtimor	2,500
Transporti publik	
Telekomunikimet	80 - 300
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 - 180
Ndërmarrjet ndërtimore	400
Autoshkollat	200
Pompat e benzinës	300- 400
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	100 - 200

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.